



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, nenin 41 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese, me datë 25.04.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.Mentor Ferizi**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Galip Avdiu.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Mentor Ferizi dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 22.04.2024, Nr.09/1-698/2024, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal z.Galip Avdiu, i cila ka dhënë dorëheqje, për arsye të angazhimeve tjera.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rënditur është z.Mentor Ferizi.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 25.04.2024

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Kreshnik Radoniqi